
*DEKLARATA
E GJYQATARËVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË*

Në këtë ditë të rëndë për drejtësinë shqiptare, gjyqtarët e Republikës, të bashkuar në një zë, shprehin dhimbjen e thellë, tronditjen njerëzore dhe indinjatën institucionale për ngjarjen tragjike që i mori jetën kolegut tonë, gjyqtarit Astrit Kalaja.

Kjo nuk është vetëm humbja e një njeriu të drejtësisë — është një plagë për gjithë sistemin, një goditje ndaj shtetit të së drejtës dhe një sulm ndaj pavarësisë së gjyqësorit. Vrasja e një gjyqtari në sallën e gjykimit është kufiri i fundit i cenimit të sigurisë dhe dinjitetit të drejtësisë.

Në këtë moment dhimbjeje e reflektimi, ne deklarojmë me vendosmëri:
Drejtësia nuk do të përkulet.

Asnjë akt dhune, kërcënimi apo fushatë urrejtjeje nuk do ta ndalë gjyqtarin shqiptar nga përmbushja e detyrës së tij kushtetuese. Pavarësia e gjyqësorit nuk është privilegj, por garanci për çdo qytetar që kërkon mbrojtje përmes ligjit.

Ngjarja e rëndë është pasojë e një klime të helmuar fyerjesh dhe kërcënimesh ndaj gjyqtarëve, e ushqyer nga gjuha e urrejtjes dhe ndërhyrjet e papërgjegjshme që kanë minuar besimin publik. Kjo klimë duhet të marrë fund.

Ne, gjyqtarët e Republikës, nuk do të lejojmë më që heshtja të interpretohet si dobësi. Do të reagojmë me dinjitet dhe përgjegjësi. Nuk kërkojmë privilegje — kërkojmë siguri, respekt dhe kushte për ushtrimin e ndershëm të detyrës.

Kjo ngjarje është një thirrje për veprim institucional. Sistemi gjyqësor po përballët me mungesë sigurie, godina të amortizuara, ngarkesë të papërballueshme pune dhe mungesë mbështetjeje. Drejtësia ka nevojë për forcim, për kushte të sigurt dhe për institucione që veprojnë, jo që heshtin.

Këshilli i Lartë Gjyqësor duhet të reagojë me forcë, përgjegjësi dhe guxim institucional. Kjo nuk është thirrje për konflikt, por për përgjegjësi.

Po kështu, pushteti ekzekutiv dhe legjislativ duhet të marrin përgjegjësinë për gjendjen ku ndodhet sot drejtësia. Shteti nuk mund të kërkojë drejtësi të pavarur, nëse nuk garanton kushtet minimale për ushtrimin e saj. Siguria në gjykata është kusht për ekzistencën e shtetit të së drejtës.

Në këtë frymë reflektimi dhe uniteti, Mbledhja e Gjyqtarëve të Republikës së Shqipërisë shpreh vullnetin e qartë mbi këto angazhime:

Siguria gjyqësore:

- Krijimi i një Grupi Ndërinstitucional me përfaqësim nga KLGJ, KLP, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Brendshme, Policia e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese për organizimin e një Forumi Kombëtar për Sigurinë Gjyqësore.
- Hartimi i një Platforme Kombëtare për Sigurinë e Gjyqtarëve dhe Gjykatave.
- Vendosja e një force të posaçme sigurie në gjykata dhe ndërtimi i protokolleve të reagimit ndaj incidenteve.
- Hartimi dhe zbatimi i një Platforme Kombëtare për Sigurinë Gjyqësore.
- Miratimi dhe zbatimi i menjëhershëm i masave konkrete për garantimin e sigurisë fizike në gjykatë dhe kushteve të ushtrimit të funksionit gjyqësor.
- Ndërhyrje të menjëhershme në ligjet ose aktet nënligjore që rregullojnë sistemin gjyqësor për të garantuar siguri fizike, jetësore, shëndetësore dhe pasurore për gjyqtarët dhe stafin e gjykatave.
- Miratimin e një strategjie kombëtare për ndërtimin e godinave të gjykatave në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
- Inspektim kombëtar i gjykatave për siguri, akses dhe kushte pune. Standardizim i procedurave të sigurisë dhe trajnime për menaxhimin e krizave. Pajisja e të gjitha gjykatave me skaner dhe detektor për garantimin e sigurisë në gjykata.

Përfaqësimi institucional dhe organizimi i brendshëm:

- Krijimi i dy grupeve të përhershme pune pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor për ideimin e nismës për ndryshime të akteve ligjore dhe nënligjore në lidhje me statusin e magjistratëve dhe për organizimin e sistemit gjyqësor.
- Ndërgjegjësimi publik dhe bashkëpunimi me median.
- Promovim i një komunikimi profesional që shmang gjuhën denigruese.
- Refuzim i gjuhës së urrejtjes, fyerjeve dhe kërcënimeve si normalitet në diskursin publik dhe politik ndaj gjyqtarëve.

Përgjegjësi dhe veprim institucional:

- Nxitje për KLGJ që të ushtrojë me forcë mandatin kushtetues.
- Kërkesë që Kuvendi dhe Qeveria të marrin masa konkrete për përmirësimin e kushteve të punës në gjykata.

Angazhime morale e profesionale të gjyqtarëve:

- Përkushtim për gjykim në kohë, vendime të arsyetuara dhe qëndrueshmëri në jurisprudencë.
- Pranim i përgjegjësisë për forcimin e brendshëm të sistemit si themel i autoritetit moral të drejtësisë.

Në kujtim të gjyqtarit të rënë në krye të detyrës, Astrit Kalaja:

- Njohja e statusit **“Dëshmor i Atdheut”** gjyqtarit Astrit Kalaja.
- Salla e Mbledhjeve të Gjyqtarëve pranë godinës së KLGJ të marrë emrin e të ndjerit, gjyqtarit Astrit Kalaja.

Ngjarja e 6 Tetorit nuk duhet të mbetet kujtesë e dhimbshme, por moment zgjimi kombëtar për drejtësinë shqiptare.

Ne nuk kërkojmë keqardhje — kërkojmë veprim.

Sepse një gjyqtar i pambrojtur është një drejtësi e pambrojtur, dhe një drejtësi e pambrojtur është një qytetar pa shpresë.

Ne angazhohemi solemnisht që, pavarësisht tronditjes, të vijojmë të gjykojmë me paanshmëri, ndershmëri dhe kurajë.

Drejtësia shqiptare nuk dorëzohet — ajo ringrihet.

Drejtësia nuk do të ndalet. Ajo do të vazhdojë të veprojë me guxim, për të mbrojtur lirinë, të drejtat dhe dinjitetin e çdo qytetari shqiptar.

GJYQTARËT E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tetor 2025